



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**Datë: 04.08.2025
Numër Protokolli: 5238/2025**

A.nr.1042/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1042/2025, të datës 02.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, P.Z, kundër organit të punësimit/ Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.08.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1042/2025, e datës 02.06.2025 e parashtruar nga ankuesi, P.Z.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 12.05.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi, P.Z (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), me datë 02.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1042/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1042/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00017244**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 20.03.2025, nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për pozitën Drejtor i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, klasa e pozitës, Drejtues i mesëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 10.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 16.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me nr prot 3694/2025 të datës 02.06.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit e datës 20.03.2025 me numër reference RN00017244; Vendimi i datës 29.04.2025 për refuzimin e aplikacionit; Njoftimi i datës 12.05.2025 për vlerësimin e kandidatëve në testin me shkrim. Njoftimin e datës 12.05.2025 për njoftimin e përfundimit të procedurës së rekrutimit pa kandidatë fitues.

Nga shkresat e lëndës Kolegji konstatoi se Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 20.03.2025 ka njoftuar për shpalljen e konkursit Rn00017244 për pozitën Drejtues i Mesëm titulli i vendit të punës “Drejtor i Qendrës së Paraburgimit” Prishtinë.

Kolegji konstaton se konkursi është shpallur në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi dhe kriteret formale kanë qenë si vijon:

- Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).
- Kërkesat specifike: Nuk ka
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijim:

1. Tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose
2. Dy vite (2) përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), Ose
3. Një vitë (1) përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoratës).

Kolegji i Këshillit në trajtim të pretendimeve të ankuesit ka analizuar dosjen e ankuesit të cilën e ka bashkëngjitur organi punëdhënës dhe ankuesi në ankesën e tij dhe ka konstatuar se, sipas dosjes së bashkëngjitur nga organi punësimit, Kolegji konstaton se NJMBNJ në SHKK drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe juridike kur ka refuzuara aplikacionin e ankuesit për shkak të mungesës së përvojës së punës në pozita drejtuese ashtu siç është përshkruar më lartë, sepse nga shkresat e bashkëngjitur nga institucioni ankuesi ka dëshmuar se ka përvojë drejtuese vetëm për 3 muaj nga data 25.10.2028 deri më datë 25.01.2019. *Ankuesi në ankesën e tij ka bashkëngjitur edhe dëshmi të tjera për përvojën drejtuese të punës por për Kolegjin ka qenë jo relevante sepse aplikimi është dashur të kompletohet me rastin e aplikimit për pozitën e lartshënuar të shpallur nga ana e SHKK-së.*

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1042/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, P.Z;
- Njësisë se Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.